



## Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 09.07.2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 06.07.2019 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "NTP Burimi Dekor" për aktivitetin: "Furnizimi me inventar" dhe me numër të prokurimit: 616 -20-1293-111 nxjerr:

### V E N D I M

Aprovohet kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik "Burimi Dekor" e datës 06.07.2020 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizimi me inventar" dhe me numër të prokurimit: 616 -20-1293-111, kundër *Njoftimit për Vendimin e AK-se te datës 02.07.2020*, te publikuar ne web-faqe te KRPP-së.

1. Anulohet *Njoftimi për Vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës 02.07.2020* dhe aktiviteti kthehet ne rivlereresim;
2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

### A r s y e t i m

Operatori Ekonomik "**NTP Burimi Dekor**" me datë 06.07.2020 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "**Furnizimi me inventar**" dhe me numër të prokurimit: 616 -20-1239-111

Autoriteti Kontraktues, me datë 09.07.2020 ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon:

-Pretendimet lidhur me mungesën e dorezimit të specifikimeve teknike nga OE-ik "Blendi" dhe Media Tech" janë të bazuara, pasi që ata kanë dorezuar vetëm specifikimet e paraqitura në dosjen e tenderit dhe i kanë paraqitur si specifikime të vetat edhe pse në piken 9.2 është kërkuar se OE-ik duhet të dorezojnë specifikimet teknike për artikujt e ofruar duke i nenvizuar produktet që ofrohen dhe për këtë pretendim i juaj se AK-ja është dashtë të kërkojë sqarime është i bazuar;

Pretendimi tjetër se dy OE-ik "Blendi" dhe "Mediatech" nuk e ka të regjistruar veprimtarinë perkatese që lidhet me furnizimet në këto aktivitete është i bazuar, por ju sqarojmë se AK-ja nuk e ka kërkuar decidivisht këto dhe bazuar në faktin se ata kanë dëshmi për furnizime të tilla nuk paraqet ndonjë shëmbetje substanciale;

-Pretendimi se OE-ik "Blendi" nuk e plotëson kriterin e përcaktuar të referencave dhe për këto arsye edhe i është kërkuar sqarim plotësues, por komisioni nuk ka vërejtur se në sqarimet plotësuese i njëjti ka deguar si dëshmi një referencë me datë të ndryshuar (datë 02.03.2020) dhe me të dhëna të njëjta me referencën e dorëzuar në tender (datë 27.12.2018 vlera 7,569.00 €). Bazuar në këto dhe në faktin se një referencë ka të bëjë me furnizimin me pajisje sportive rrjedh se ky OE-ik "Blendi" nuk plotëson kërkesën e dëshmi për realizim të furnizimeve të ngjajshme (furnizim me inventar) në vlerën e kërkuar;

-Poashtu pretendimi lidhur me mospërputhjen në mes të referencës dhe vlerës së përcaktuar të kontratës në listë është i bazuar dhe kjo është dëshmi të sqarohet;

-Poashtu pretendimi për mospërputhje në mes të listës së kontratave dhe dëshmi të dorëzuara pas sqarimeve është i bazuar dhe se kjo mospërputhje është dëshmi të sqarohet nga komisioni i vlerësimit.

Nga konstatimet paraprake rrjedh se në fazën e rivlerësimit duhet të sqarohen të gjitha paqartësitë e cekura më lartë.

Bazuar në sqarimet e dhëna për pretendimet tuaja u vendos si në dispozitiv.

**Këshilla juridike:**

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së.

**Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.**

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit

